

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.04.2023*

04.04.2023

Ora 19:11

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e listave shumemërore të subjektit zgjedhor “Partia Demokratike”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve: **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,**
- **Parti politike:** **PDIU**
- **OJQ:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Mirëmbërëma! Atëherë në rend të ditës të kësaj seance kemi... Janë 35 vendime për të shqyrtuar. Nga këto kemi gati 6 projektvendime. Kemi projektvendimin që lidhet me shqyrtimin e kërkesës për miratimin e listave shumemërore të subjektit zgjedhor “Partia Demokratike”, të subjektit zgjedhor “Bashkë Fitojmë”, të subjektit zgjedhor “Partia Social Demokrate”, të subjektit zgjedhor “Aleanca Progresiste LZHK”, të subjektit zgjedhor “Partia Shqiptare Atdheu dhe të subjektit zgjedhor “Partia Balli Kombëtar”. Fillojmë me pikën e parë.

Z. Y. Merkaj: Faleminderit! Atëherë Partia Demokratike është regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023 dhe i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dokumentacionin për miratimin e

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.04.2023*

listave shumemërore. Administarta e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka bërë verifikimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak për bashkitë Berat, Durrës, Elbasan, Fier, Lezhë, Lushnjë, Shkodër, Tiranë, Vlorë, Kamëz dhe Korçë të Partisë Demokratike. Rezulton që është në përputhje me nenin 67 të Kodit Zgjedhor. Gjithashtu kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak të këtyre bashkive kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularët e vetëdeklarimit dhe nga verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit rezulton se kandidatët nuk kanë deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalim të ligjit nr. 138, të vitit 2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ku në përgjigje të kërkesës sonë Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ende nuk ka kthyer përgjigje, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka dërguar verifikimin e të dhënave për kandidatët për anëtarë të Këshillit Bashkiak të këtyre bashkive dhe rezulton se kandidatët nuk janë në kushtet për të mos tu regjistruar si kandidat për zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023. Pas verifikimeve përkatëse dhe dokumentacionit në tërësi të listave shumemërore konstatohet se është në përputhje me nenin 67, 72 dhe 73 të Kodit Zgjedhor dhe për këtë arsye i propozojmë Komisionerit miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak të kësaj partie me bashkitë përkatëse. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Mirë faleminderit! Ateherë, e miratojmë listën shumemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillave bashkiak, të Bashkive Durrës, Elbasan, Berat, Fier, Lezhë, Lushnjë, Shkodër, Tiranë, Vlorë, Kamëz dhe Korçë për subjektin zgjedhor Partia Demokratike.

Vendimi nr. 260

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.04.2023*

04.04.2023
Ora 19:14

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e listave shumëmemërore të Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve: **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,**
- **Parti politike:** **PDIU**
- **OJQ:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Kalojmë tek pika tjetër.

Z. Y. Merkaj: Koalicioni “Bashkë Fitojmë” është regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023 dhe ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dokumentacionin për miratimin e listave shumëmemërore. Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka bërë verifikimin e listave shumëmemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak për bashkitë Berat, Durrës, Elbasan, Fier, Lezhë, Lushnjë, Shkodër, Tiranë, Vlorë, Kamëz dhe Korçë të Koalicionit “Bashkë Fitojmë”. Dokumentacioni rezulton që është në përputhje me nenin 67 dhe 72 të Kodit Zgjedhor. Kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak të këtyre bashkive kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.04.2023*

formularët e vetëdeklarimit, ku nga verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit rezulton se kandidatët nuk kanë deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalim në ligjin nr. 138, të vitit 2015. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ende nuk i ka kthyer përgjigje kërkesës sonë për verifikimin e të dhënave të kandidatëve, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka dërguar verifikimin e të dhënave për kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak të këtyre bashkive dhe konstatohet se nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin e kandidatëve për zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023. Për sa më sipër, duke qenë se dokumentacioni në tërësi i listave shumemërore është në përputhje me nenin 67, 72 dhe 73 të Kodit Zgjedhor, i propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak të bashkive të mësipërme për Koalicionin “Bashkë Fitojmë”. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Mirë faleminderit! Miratojmë listën shumemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillave bashkiak, të Bashkive Berat, Durrës, Elbasan, Fier, Lezhë, Lushnjë, Shkodër, Tiranë, Vlorë, Kamëz dhe Korçë për subjektin zgjedhor “Koalicioni Bashkw Fitojmw”.

Vendimi nr. 261

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.04.2023*

04.04.2023
Ora, 19:16

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e listave shumemërore të subjektit zgjedhor “Partia Socialdemokrate”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve: **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,**
- **Parti politike:** **PDIU, PL**
- **OJQ:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Kalojmë tek pika tjetër.

Z. Y. Merkaj: Partia Socialdemokrate është regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023 dhe ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dokumentacionin për miratimin e listave shumemërore. Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka bërë verifikimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak për bashkitë Berat, Durrës, Elbasan, Fier, Lezhë, Lushnjë, Shkodër, Tiranë, Vlorë, Kamëz dhe Korçë të Partisë Socialdemokrate. Konstatohet se është në përputhje me nenin 67 dhe 72 të Kodit Zgjedhor. Kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak të këtyre bashkive kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularët e

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.04.2023*

vetëdeklarimit dhe nga verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit rezulton se kandidatët nuk kanë deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalim në ligjin nr. 138, të vitit 2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, e cila ende nuk i ka kthyer përgjigje kërkesës sonë për verifikimin e të dhënave të kandidatëve, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka dërguar verifikimin e të dhënave për kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak të këtyre bashkive për Partinë Socialdemokrate. Pas verifikimeve konstatohet se dokumentacioni i paraqitur për listat shumemërore është në përputhje me nenin 67, 72 dhe 73 të Kodit Zgjedhor dhe për këto arsye i propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak të këtyre bashkive për Partinë Socialdemokrate. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Mirë faleminderit! Miratohet lista shumemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillave bashkiak, të Bashkive Berat, Durrës, Elbasan, Fier, Lezhë, Lushnjë, Shkodër, Tiranë, Vlorë, Kamëz dhe Korçë për subjektin zgjedhor “Partia Socialdemokrate”.

Vendimi nr. 262

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.04.2023*

04.04.2023
Ora 19:8

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e listave shumemërore të subjektit zgjedhor “Aleanca Progresiste Lëvizja për Zhvillim Kombëtar”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve: **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,**
- **Parti politike:** **PDIU, PL**
- **OJQ:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Kalojmë tek pika tjetër.

Z. Y. Merkaj: Subjekti Zgjedhor “Aleanca Progresiste Lëvizja për Zhvillim Kombëtar” është regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023 dhe ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dokumentacionin për miratimin e listave shumemërore. Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka bërë verifikimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak për bashkitë Berat, Durrës, Elbasan, Fier, Lezhë, Lushnjë, Shkodër, Tiranë, Vlorë, Kamëz dhe Korçë të partisë “Aleanca Progresiste Lëvizja për Zhvillim Kombëtar”. Kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak të këtyre bashkive kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.04.2023*

formularët e vetëdeklarimit dhe nga verifikimi paraprak i formularëve të vetëdeklarimit rezulton se të gjithë kandidatët nuk kanë deklaruar të dhëna që kanë të bëjnë me parashikimet për ndalim në ligjin nr. 138, të vitit 2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, e cila ende nuk i ka kthyer përgjigje kërkesës sonë për verifikimin e të dhënave të kandidatëve, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka dërguar verifikimin e të dhënave të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak të këtyre bashkive, për partinë “Aleanca Progresiste Lëvizja për Zhvillim Kombëtar”. Pas verifikimeve përkatëse të dokumentacionit të listave shumemërore konstatohet se janë në përputhje me nenin 67, 72 dhe 73 të Kodit Zgjedhor dhe për këtë arsye i propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak të këtyre bashkive për subjektin politik “Aleanca Progresiste Lëvizja për Zhvillim Kombëtar”. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Mirë faleminderit! Miratojmë listën shumemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillave bashkiak për bashkitë Berat, Durrës, Elbasan, Fier, Lezhë, Lushnjë, Shkodër, Tiranë, Vlorë, Kamëz dhe Korçë për subjektin zgjedhor “Aleanca Progresiste Lëvizja për Zhvillim Kombëtar”.

Vendimi nr. 263

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.04.2023*

04.04.2023
Ora 19:19

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e listës shumëmemërore të këshillit bashkiak, Bashkia Elbasan, të subjektit zgjedhor “Partia Ora e Shqipërisë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve: **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,**
- **Parti politike:** **PDIU, PL**
- **OJQ:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Kalojmë tek pika tjetër.

Z. Y. Merkaj: subjektit zgjedhor “Partia Shqiptare Atdheu” është regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023 dhe ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dokumentacionin për miratimin e listave shumëmemërore. Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka bërë verifikimin e listave shumëmemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak për Bashkinë Lezhë për subjektin zgjedhor “Partia Shqiptare Atdheu”. Dokumentacioni konstatohet se është në përputhje me nenin 67 dhe 72 të Kodit Zgjedhor. Kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak të Bashkisë Lezhë të subjektit zgjedhor “Partia

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.04.2023*

Shqiptare Atdheu” kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularët e vetëdeklarimit dhe nga verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit rezulton se kandidatët nuk kanë deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalim në ligjin nr. 138, të vitit 2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, e cila ende nuk i ka kthyer përgjigje, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka dërguar verifikimin e të dhënave për kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak të Bashkisë Lezhë, të subjektit zgjedhor “Partia Shqiptare Atdheu”. Pas verifikimeve konstatohet se të dhënat nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin e tyre në zgjedhjet e datës 14 maj 2023 . Në këto kushte duke qenë se dokumentacioni është në përputhje me nenin 67, 72 dhe 73 të Kodit Zgjedhor, i propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak, të Bashkisë Lezhë, të subjektit zgjedhor “Partia Shqiptare Atdheu”. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Mirë faleminderit! Miratojmë listën shumemërore të këshillit bashkiak, Bashkia Elbasan, të subjektit zgjedhor “Partia Ora e Shqipërisë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Vendimi nr. 264

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.04.2023*

04.04.2023
Ora 19:21

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e listave shumemërore të këshillit bashkiak, Bashkitë Elbasan dhe Vlorë, të subjektit zgjedhor “Partia Balli Kombëtar”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve: **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,**
- **Parti politike:** **PDIU, PL**
- **OJQ:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Kalojmë tek pika tjetër.

Z. Y. Merkaj: Subjekti zgjedhor “Partia Balli Kombëtar” është regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023 dhe ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dokumentacionin për miratimin e listave shumemërore. Administarta e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve pasi ka bërë verifikimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak për bashkitë Elbasan dhe Vlorë të Partisë Balli Kombëtar. Rezulton se dokumentacioni është në përputhje me nenin 67 dhe 72 të Kodit Zgjedhor. Kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak të Bashkive Elbasan dhe Vlorë të kësaj partie kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularët e

*Zbardhi materialin audio
Arlinda Bahollari*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.04.2023*

vetëdeklarimit. Nga verifikimi paraprak i formularëve të vetëdeklarimit konstatohet se kandidatët nuk kanë deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalim në ligjin nr. 138, të vitit 2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, e cila ende nuk i ka kthyer përgjigje kërkesës sonë për verifikimin e të dhënave të kandidatëve, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka dërguar verifikimin e të dhënave për kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak për bashkitë Elbasan dhe Vlorë për subjektin zgjedhor “Partia Balli Kombëtar”. Duke qenë se dokumentacioni është në përputhje me nenin 67, 72 dhe 73 të Kodit Zgjedhor i propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak në bashkitë Elbasan dhe Vlorë të subjektit zgjedhor “Partia Balli Kombëtar”. Bashkëlidhur keni dhe listën e kandidatëve. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Mirë faleminderit! Miratojmë listën shumemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak për bashkitë Elbasan dhe Vlorë, për subjektin zgjedhor “Partia Balli Kombëtar”.

Vendimi nr. 265

*Zbardhi materialin audio
Arlinda Bahollari*

